



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Dokument parlamentar

### PROCESVERBAL

Datë 04.12.2014, ora 11:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”.

#### **Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Robert Bitri, Artan Gaçi, Esmeralda Shkja, Artur Bushi, Besnik Baraj, Piro Kapurani, Ervin Koçi, Namik Kopliku, Gentian Bejko, Rakip Suli, Sadri Abazi, Vladimir Kosta, Ervin Buashti, Dashamir Kamberi, Blerina Gjylameti, Silvi Caka dhe Kejdi Mehmetaj.

#### **Mungojnë:**

Genc Ruli, Sherefedin Shehu, Ardian Turku, Agron Duka, Besnik Dushaj, Voltana Ademi, Gjergji Papa, Helidon Bushati, Kozma Dashi, Dashamir Tahiri, Parid Cara, Ilir Xhakolli, Fatmir Toçi, Bujar Derveni dhe Monika Kryemadhi.

#### **Të ftuar:**

Ilir Bejtja - zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë.

Sokol Kikino - drejtor Njesisë së Projekteve të BB-së.

Miranda Lila – këshilltare e ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Dardan Malaj – këshilltar i ministrit, për mediet.

Milbana Treska - drejtoreshë e Drejtimit të Borxhit Publik, në MF.

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen, a janë konfirmuar emrat që do të vijnë në mbledhjen e nesërme?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Sot në rend të ditës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”.

Të ftuar në komision kemi:

Zotin Ilir Bejtja, zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë, zotin Sokol Kikino, drejtor i njësisë së Projekteve, zonjën Miranda Lila, këshilltare e ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe zotin Dardan Malaj, këshilltar i ministrit për mediet.

Mirëserdhët në komision!

Zoti Sokol Kikino është drejtor i njësisë së projekteve, ndërsa Miranda Lila, është këshilltare për marrëdhëniet me parlamentin.

Zoti Koçi, keni fjalën në cilësinë e relatorit!

**Ervin Koçi** – Kjo hua është në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit energjetik. Ka një vlerë prej 112 milion euro dhe vjen në vijim të reformave të ndërmarra nga qeveria në të gjithë sektorin energjetik.

Projekti ka 4 komponentë kryesorë: komponenti i parë është për plotësimin e nevojave me energji, për arsye se prodhimi vendas nuk i plotëson nevojat. Është një mbështetje afatshkurtër për importin energjisë.

Komponenti i dytë ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes.

Komponenti i tretë ka financimin për përmirësimin e matësve, transmetimit dhe qendrës së të dhënave dhe komponenti i katërt, është për mbështetjen e reformave në sektorin energjetik dhe zbatimin e projektit.

Është për t'u vlerësuar, sepse kjo hua vjen pas reformës që ka bërë qeveria në sektorin energjetik, për marrëveshjen që bëri në kompaninë CEZ-i, pasi i mori përsëri aksionet, qoftë për sa i përket reformave që ka bërë së fundi, të cilat kanë krijuar besim te partnerët tanë.

Mbetet për t'u vlerësuar si hua, pasi norma e interesit është shumë e ulët. Kredia ka një afat maturimi prej 22,5 vjetësh. Tarifa e angazhimit është 0,25% e shumës së kredisë dhe interesi është: norma e referencës + marzhin e pandryshueshëm (0,75%), por qeveria do t'ia çojë të gjithë sektorit me normë interesi 0,75%. Për 7 vjet, qeveria nuk do ta paguajë principalin, por do të paguajë vetëm interesin.

**Eduard Shalsi** – Zoti Bitri do të dijë më shumë për çështjen e normës së interesit, pra, kushtet e kredisë.

**Ervin Koçi** – Interesi bazë është: norma e referencës + marzhin e pandryshueshëm (0,75%). Norma e referencës është pak a shumë e ndryshueshme, por pak përgjithësisht është... (do ta shpjegojë edhe drejtoresha e Ministrisë së Financave).

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

1,1% venë të dyja (Euribor + 0,75%), por qeveria merr përsipër që këtë shumë që e merr Ministria e Financave, ta transferojë ose ta huazojë te KESH-i, OSHE-ja dhe OST-ja, me normë interesi 0,75%. Marzhi prej 0,35%, do të përballohet nga buxheti i shtetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Robert Bitri** – Sa përqind e kësaj shume do të vejë për blerje energjie dhe sa do të vejë për teknologjinë?

**Ervin Koçi** – Mendoj se këtë përgjigje duhet ta japin përfaqësuesit e qeverisë. Unë, si relator i projektligjit, jam dakord me këtë hua, e cila do ta përmirësojë ndjeshëm këtë sektor, në të gjitha aspektet, por sidomos në infrastrukturë, për të përballuar nevojat urgjente që ka sektori dhe për të importuar energji. Ftoj komisionin ta mbështesë nismën, për ta përcjellë më pas te komisioni përgjegjës.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Koçi!

Para se t'u jap fjalën përfaqësuesve të ministrisë, do të doja të dija për orientim: përse shuma 150 milionë euro dhe jo (të themi), 50 milionë apo 300 milionë?

**Sokol Kikino** – Shuma është 150 milionë dollarë, që është e barabartë me 112 milionë euro.

**Eduard Shalsi** – Nëse shuma është 150 milionë dollarë, përse flasim për euribor dhe nuk flasim për libor?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord. Si është arritur në këtë shumë, pra, përse 112 milionë euro dhe jo një shumë tjetër?

E dyta: si janë përcaktuar komponentët që do të financojë kjo shumë? A do të shkohet drejt matësve inteligjentë fillimisht dhe pastaj rrjetit, do të shtohet një pjesë e vlerës së energjisë, pastaj e matësve inteligjentë, pra strategjia e shpenzimeve dhe investimeve në rrjetin energjetik?

Kjo është të paktën për ta orientuar diskutimin. Pastaj kolegë të ndryshëm, jam i sigurt që do të kenë pyetje.

**Ilir Bejtja** – Kredia duhet parë.

Në qoftë se do të shikonim nevojën tonë për investime, do të kishte qenë mrekulli të kishte qenë 900 milionë dollarë, se kaq kemi në dorë sot që ta zgjidhim totalisht problemin.

Po të kemi parasysh aftësitë mbuluese që ka buxheti i shtetit sot në kushtet e regjimit financiar, të cilin po e ndjekim në çdo investim, kapacitetet e garancisë sovrane që ne mund të mbulonim nuk na lejonin të merrnim më shumë se 150 milionë dollarë ose 112 milionë euro. Arsyeja e vetme është se kompania ose tri kompanitë i kanë të konsumuara krejt kapacitetet e tyre kolaterale për të marrë më tepër se kaq dhe, duke qenë se janë totalisht me kapital publik, në këtë rast për çdo kompani me kapital publik kërkohet edhe garanci sovrane, në mënyrë që borxhi të jetë totalisht i siguruar. Pra, kapaciteti i buxhetit shqiptar nuk ishte më i madh se 112 milionë euro për ta mbuluar këtë kredi. Në këtë logjikë, ne kemi bërë një prioritizim, duke marrë tri elemente bazë.

Së pari, kushtet e emergjencës që janë gjithmonë trokitëse në dyert e sistemit energjetik shqiptar, sepse varen totalisht nga klima, nga kushtet e motit.

**Robert Bitri** – Për blerjen e energjisë.

**Ilir Bejtja** - Duhet një garanci për blerje energjie, në mënyrë që të garantojmë furnizim të qëndrueshëm të tregut energjetik. Pra, ajo nuk është e dhënë që patjetër të konsumohet, por të mbetet në formë garancie për blerje energjie. I është dhënë ndërmarrjes gjeneruese, KESH-it. Kjo vjen nga detyrimi që KESH-i ka për të furnizuar tregun e rregulluar, me tarifë të rregulluar. Që KESH-i ta garantojë këtë furnizim duhet të japë rregullisht nga 4,4 deri në 4,7 tera energji çdo vit dhe pjesë kryesore mbi 70% e kësaj energjie duhet të jetë prodhimi i vet (furnizuesi publik me shumicë); kështu është i programuar, e ka prodhimi i hidrocentraleve të vogla.

Në kushtet ku jemi, kur kemi filluar remontin e digës së Komanit, turbinën e Komanit dhe deri në mesin e vitit 2017 ne do të jemi me 1,15 turbina\_\_\_\_\_ (nuk dëgjohet mirë).

**Eduard Shalsi** – Falemnderit z. Bejtja.

**Ilir Bejtja** – Prodhimi ynë nuk mund të jetë në kushte mesatare të motit më shumë se 3,2-3,3 teravatë nga 3,8-4 teravatë që këta duhet të lëvrojnë. Kështu që duhet të kenë një garanci, nëse moti do të përkeqësohet se kaq sa jemi, që ne të kemi një fond rezervë që do të jepte mundësinë të blinin energji jashtë për të furnizuar tregun me tarifë të rregulluar.

Për të arritur te kjo shifër janë bërë analiza të detajuara matematikore. Është pasur parasysh edhe trendi i çmimeve të importit të energjisë elektrike dhe nevoja që ne kemi për të kompletuar kërkesën për energji në vend.

Pjesa tjetër e kredisë, prej 93 milionë dollarësh, po flas në dollarë se e kam në termat e studimit të marrëveshjes, do të përdoret nga OSHEE-ja, nga shpërndarja, bashkë me një pjesëmarrje të saj në bankë me 46 milionë dollarë me kosto lokale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për ta kompletuar të gjithë projektin për projektet që janë zgjedhur.

Projekti përmban brenda 300 mijë matës, të cilët do të blihen dhe nuk janë *smartmeters*, por në nivele të ndryshme, nga 35 kilovoltëshi deri te 0,4-shi edhe për familjarët.

Është paraparë nevoja që ne kemi sot për zëvendësimin e matësve ekzistues dhe për kompletimin e rreth 60 mijë konsumatorëve, të cilët janë pa matës. Kemi bërë një përlllogaritje. Nga 930 matës që ne kemi në treg, një pjesë e mirë e tyre janë të dëmtuar për shkak të anakronizmit të kohës, pra ka kaluar shumë kohë që kur janë instaluar për herë të parë dhe nuk u përgjigjen programeve teknike për matje.

Elementi i dytë ka qenë dëmtimi për shkak të vjedhjes ose të manipulimit të rrjetit nga konsumatorët. Nga studimi që kemi bërë, na ka rezultuar se në çdo tre matës që ne heqim të dëmtuar, mund të rikuperojmë 1,8 prej tyre në total. Kjo ka sjellë nevojën për matësit që na duhen për të kompletuar të gjithë sistemin, për të mos pasur as edhe një abonent pa matës në treg. Kjo brenda vitit 2015. Pra, blerja mbyllet brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 2015, kurse instalimi vazhdon deri në fund të vitit 2016. Pastaj janë për t'u bërë edhe disa nënstacione, të cilat lidhen me qëndrueshmërinë e furnizimit të energjisë, pra pika tregu...

**Eduard Shalsi** – Brenda kësaj të dytës?

**Ilir Bejtja** – Te pjesa e programit të dytë.

Këto nënstacione janë në stacione të disponuara nga shpërndarja. Bëhet fjalë për një nënstacion të ri në Tiranë dhe nënstacioni i qendrës që ndodhet prapa Pesëmbëdhjetëkatëshit.

Përveç këtyre, janë edhe disa nënstacione të tjera në aksin Tiranë-Durrës dhe në Fier në total ne e kompletojmë me qëndrueshmërinë, me investime. Të gjitha këto shkojnë bashkë dhe rreth 14 milionë dollarë shkojnë vetëm për nënstacionet.

Kemi më pas komponentin e tretë, rreth 22 milionë dollarë, i cili i lëvrohet sistemit të transmetimit, për vendosjen e matësve për të gjitha nivelet ku ne shpërndajmë energjinë nga 110 në 35 dhe 20. Deri në këto momente nuk kemi matësa në hyrje dhe në dalje të çdo njësie ndërmjetëse aksesit.

Kjo na bën të luftojmë humbjet nga vjedhja ose nga ndërhyrjet e paligjshme. Në çdo çast ne dimë se sa energji hyn dhe se sa del dhe se ku është defekti.

Në thelb e gjithë historia qëndron në luftimin, në radhë të parë të evazionit për shkak të lidhjeve të paligjshme, të abuzimeve dhe pjesa tjetër për të rritur cilësinë e shpërndarjes me rreth 2 mijë kilometër kabull, i cili do të zëvendësojë atë ekzistues në sistemin e tensionit të ulët 6-10 për ta bërë jo të gjithin, por pjesën që zëvendësohet 20 kilovolt, duke reduktuar humbjet teknike dhe të mbahet në standardet ndërkombëtare. 20- shi ofron sot standarde ndërkombëtare teknike për transmetimin e energjisë te konsumatori final. Në momentin që flasim ne kemi mbrojtje teknike të deklaruara nga shpërndarja: 21,04% nga një përlllogaritje që na ka dalë kjo përqindje, megjithatë nuk jemi në gjendje nëse është kaq, 30% apo diçka midis këtyre dy shifrave, por jo më pak se 21,04.

Rrjeti është tejet i dëmtuar nga ndërhyrjet, është tejet i dëmtuar nga vjetërsia, prandaj ka nevojë që të zëvendësohet. Përmirësimi në rrjet sjell një efekt në ndryshimin e cilësisë së shërbimit dhe në stabilitetin e shpërndarjes nga 3-5%. Kjo është një shifër e konsiderueshme kur flasim për të dhëna teknike. Garantohet tensioni, furnizimi me rrymë dhe qëndrueshmëri e rrymës, por mbi të gjitha garantohet minimumi i mundshëm i balancave, të luhatjeve të furnizimit të energjisë në sinusoidet e saj. Ne sot i kemi balancat e programuara të energjisë elektrike me energjinë e konsumuar rreth 5%, kosto, e cila rëndon direkt në tarifë, me këto ndërhyrje. Në zonat ku ndërhyhet ne pretendojmë të shkojmë te 0,5%, pra, të shkojnë në parametra maksimale teknike dhe energjia e programuar të jetë pothuajse e barabartë me energjinë faktike të kërkuar për konsumatorët.

Komponenti i katërt që lidhet me përmirësimin e menaxhimit ka të bëjë me ngritjen e tri njësive të zbatimit të projektit në secilin prej operatorëve. Një njësi e menaxhimit të projektit në qendër do të menaxhojë aplikimin dhe implementimin e projektit.

Nga ana tjetër ka edhe një zë brenda komponentit, i cili do të ofrojë asistencë teknike si në fazën e hartimit të dokumenteve për tenderimin, po kështu edhe në implementim në formën e konsulencës menaxheriale për ndërmarrjet tona. Kjo ka ardhur si pasojë e vlerësimit që banka i ka bërë licencës për sistemin energjetik shqiptar dhe për projektet që ka zbatuar deri tani kanë dalë me *high risc*. Ne nuk kemi konsistencë në zbatimin e projekteve ose e kemi atë të ulët. Konsistenca në likuidimin e detyrimeve është e ulët dhe këto japin nivele të larta risku. Për këtë arsye një pjesë e mirë e fondit ka shkuar për aspektin menaxherial të projektit, duke mos pranuar që këtë menaxhim ta bëjnë vetëm kompanitë në mënyrë të pavarur, por kjo të bëhet në mënyrë të përqendruar nga dy ministri: ajo e Energjetikës, si edhe nga ajo e Financave.

Kjo është pak a shumë panorama teknike dhe financiare e projektit. I gjithë ky investim në katër vite shkon në 275 milionë euro së bashku me kontributet e ndërmarrjeve tona si pjesëmarrëse në investime.

**Eduard Shalsi** - Faleminderit, zoti Bejtaj!

Ka një projekt që është 275 milionë dollarë, nga të cilat qeveria shqiptare ka kontribut edhe financimin e Bankës Botërore.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Atëherë, me shumë shpejtësi, zoti Bushati, pastaj zoti Kosta, zoti Abazi, dhe pastaj kalojmë në votim.

**Ervin Bushati** – Pas reformës së territorit dhe të arsimit, e treta e vërteta, është reforma e energjisë dhe duket se do të zgjasë. Do të jetë sfida e qeverisë për disa kohë. Kam tri pyetje.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Efekti i naftës, a ka ndikuar në çmimin e energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar? Ka rënë minus 37%... A janë të lidhura, ndikon në çmimin e energjisë në tregjet ndërkombëtare? Vijnë tek e dyta: sa nga këto para do të jenë investime dhe sa do të jenë blerje energjie? Neve na intereson të ketë sa më shumë investime, sepse ato qëndrojnë në radhë të parë, dhe e dyta na mësojnë të punojmë më mirë. E treta: a ka analizë tregu për të ditur se sa do të jetë çmimi që mund të përballohet nga qytetarët, dhe sa nga biznesi? Cili do të jetë kufiri deri ku mund të durojë qytetari, sepse ky do të jetë problemi dhe sfida psikologjike? A ka ndonjë studim ekonomik, dhe sa mund të jetë një çmim i propozuar, se mund të punohet dhe me çmime të diferencuara; ndryshe për biznesin, ndryshe për qytetarin, ndryshe për ca qytetarë që e kanë për mbijetesë? Do të jetë betejë e gjatë dhe kam përshtypjen se të gjitha këto shkojnë te paraja...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ilir Bejtja** – Për pyetjen e parë, se sa prej këtyre parave shkojnë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne flasim për investime të cilat nuk kanë lidhje me çmimin ndërkombëtar.

**Ervin Bushati** – E di, e di, por ti do ta blesh nesër nga tregjet.

**Ilir Bejtja** – E di, e di, prandaj doja ta filloja nga pjesa për blerjen. Ne kemi lënë një fond garancie prej 30 milionë dollarësh për blerje energjie, por që shpresojmë se nuk do t'i përdorim asnjëherë këto para, sepse sipas grafikut të hyrjes në prodhim të hidrocentraleve të vogla, ne presim që kjo energji të kompensohet me prodhimin vendës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Janë projekte që vijnë në vazhdim, vit pas viti.

Prodhimi vendas barazon totalisht kërkesën e sotme për energji, me një diferencë prej vetëm 200 gigavat.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Çmimi i brendshëm i referohet totalisht çmimit të bursës ndërkombëtare, dhe në këtë formë ne kemi rregulluar totalisht që t'i referohemi për çdo nevojë energjie kësaj burse. Pra, çmimi i vendit, që ne e kemi nxjerrë me vendim qeverie të mërkurën që shkoj, për HEC-et e vogla, do të jetë i barabartë me çmimin e bursës së Ballkanit perëndimor, bursës së Hungarisë, HUPX, e cila është bursa më pranë nesh. Ne mund t'i referoheshim dhe bursës së dikujt tjetër.

Pra, bursa së cilës ne i referohemi është bursa e Hungarisë, dhe ajo sot është 42 dollarë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kjo do të jetë tarifa që aplikohet për hidrocentralet për vitin e radhës. Nga ana tjetër, në çdo rast do të mundohemi të shikojmë që kjo formulë të mos jetë me bazë vjetore, por të jetë me bazë tremujore. Pra, t'i afrohem sa më pranë realitetit. Besoj se balancat nuk lëvizin më shumë se gjysmë euro plus apo gjysmë euro minus nga njëri tremujor në tjetrin. Të paktën kjo ka qenë eksperiencia e katër vjetëve të fundit. Bursat nga mesatarja vjetore, gjatë tremujorit lëvizin, në motin më të keq të mundshëm, në dimrin më të egër, 1.5 euro më tepër. Kjo vetëm sa saktëson marrëdhënien tonë me hidrocentralet, por nuk na pengon në përlllogaritje.

Pyetja e tretë lidhet me tarifën, me çmimin e energjisë. Nesër kemi një dëgjuesë publike me të tre operatorët. Ata do të prezantojnë objeksionet e tyre ndaj objeksioneve që ka paraqitur

ERE për metodikën e respektuar. Kemi bërë edhe ne vetë analizat tona mbi bazën e aplikimeve të tyre dhe mendojmë se do të ketë korrektive të rëndësishme, por asnjëherë çmimi nuk do të jetë më shumë sesa çmimi i sotëm mesatar i energjisë, i cili sot është 10,92.

**Eduard Shalsi** – Zoti Kosta.

**Vladimir Kosta** – Kjo është një temë shumë interesante që na intereson jo vetëm ne, por të gjithë popullit shqiptar. Unë dëgjova përgjigjet e zotit Ilir, por desha të di sa borxhe ka aktualisht sektori energjetik dhe sa është borxhi më i lartë?

**Ilir Bejtja** – Shumë.

**Vladimir Kosta** - Pyetja ime konsiston këtu: për këto borxhe nuk mund të merrni një borxh tjetër në nivelin e kësaj që keni marrë dhe të shlyeni borxhet e larta?

Pyetja tjetër, a keni investime në kaskadën e Drinit për përmbytjet? Dhe a keni në mend të shihni një perspektivë tjetër se sa është ky investim në kaskadën e Drinit dhe a ka ndonjë variant tjetër që të shpëtojë Shkodra nga përmbytjet?

Sot në mëngjes pata një takim me disa investitorë të hec-eve, të cilët janë shumë të shqetësuar për sa i përket uljes së çmimit të blerje së energjisë, kanë dalë diku, nuk e di se sa në përqindje, por diku 8 apo 10 pikë më poshtë se sa blerja numerike.

**Ilir Bejtja** – Jo, nuk është ashtu. Është bursa e çmimit të energjisë.

**Vladimir Kosta** - Jo, se e lidha unë gabim, e kanë superprodhim, dhe nuk konsiston në faktin që Europa i ka çmimet shumë të larta për energjinë e gjelbër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Monika Kryemadhi** – Jo i ka më të ulëta.

**Vladimir Kosta** – Pra, a jemi ne nivelin e Komunitetit European për blerjen çmimit ndaj investitorëve tanë?

**Eduard Shalsi** – Tani do ta ndërpresim dhe do ta vazhdojmë prapë. Tema është interesante dhe mund të ketë kolegë të tjerë që duan të flasin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të bëjmë votimin dhe pastaj bashkë me ministrin dhe me ekipin e kemi lënë që gjatë prezantimit të ligjit të energjisë seanca e parë do të jetë njohje me ligjin dhe pyetje të deputetëve në lidhje me sistemin energjetik.

Pra, ju do t'i konsolidoni pyetjet, mund t'i dërgojmë edhe një pjesë paraprakisht që të përgatiten dhe, pastaj të bëjmë një seancë të veçantë për çështjet e energjisë. Secili nga ju kristalizon pyetjet, shqetësimet që ka dhe ftojmë edhe ministrin, edhe zëvendësministrin.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me marrëveshjen? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

## **MBLEDHJA MBYLLET**